



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV

Nr. 904 / prot.
4

Tiranë më 14. 9.2017

URDHËR

Nr. 224, datë 14. 9.2017

PËR

SHKATËRRIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE, TË CILAT KANË
TEJKALUAR AFATIN LIGJOR TË PËRPUNIMIT

Baza Ligjore: Ligji Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, nenet 29 dhe 30 të tij.

Në zbatim të Urdhrit Nr.154, datë 08.06.2017 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit *Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza* Tiranë me objekt kontrolli:

- Zbatimi i Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit *Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza* Tiranë.

Grupi i kontrollit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale, u asistua nga përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët ishin njohur me Urdhrin Nr.154, datë 08.06.2017 të Komisionerit.

Kontrolluesi *Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza* Tiranë, ofron këshillim si telefonik, ashtu dhe ballë për ballë për gra e vajza, ndihmë për viktimat e dhunës në familje duke i referuar në shërbime të tjera si: strehëza, asistencë ligjore falas, kurse trajnimi për gjetjen e punës, me qëllim integrimin e grave që janë viktime të dhunës.

Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për subjektet e dhënave "punëmarrës" e "përfituese".

Përpunimi i të dhënave kryesisht realizohet në mënyrë manuale, (nëpërmjet formatit letër) si dhe në mënyrë elektronike.

Në kontrollin e ushtruar pranë këtij kontrolluesi, konstatohet se përpunohen të dhëna bazike, por dhe të dhëna sensitive të grave dhe vajzave të dhunuara fizikisht apo psikologjikisht.

Parimi i konfidencialitetit, është një nga parimet bazë të aktivitetit të kontrolluesit, por ky parim mbetet i pa konkretizuar në akte të brendshme të kontrolluesit.

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi, sipas proces verbalit të mbajtur për këtë qëllim u konstatua:

1. Kontrolluesi nuk e ka realizuar detyrimin për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit. Konstatimi përbën shkelje administrative të neneve 21 dhe 22 të ligjit - *“1. Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë”.*
2. Kontrolluesi nuk ka rregullore për mbrojtjen e të dhënave personale. Konstatimi i pikës së dytë, përbën shkelje administrative të nenit 27 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar, - *“1. Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi.
2. Kontrolluesi merr këto masa të veçanta sigurie:
2/1. Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat tekniko-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me ligjin dhe rregullore të tjera”.*
3. Kontrolluesi nuk ka nënshkruar *“Deklaratë Konfidencialiteti”* me punëmarrësit, të cilët kanë akses në mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale, sipas standartit të parashikuar në Vendimin Nr.6 të Komisionerit datë 05.08.2013. Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 28 të ligjit - *“Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj.*
4. Kontrolluesi nuk ka publikuar në portalin zyrtar të tij *“Politikat e Privatësisë”*. Informacioni i cili duhet publikuar në *“Politikat e Privatësisë”*, ka për qëllim informimin e subjekteve që vizitojnë këtë portal, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë, ruajtjes së konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë. Konstatimi i pikës së katërt, përbën shkelje administrative të nenit 18 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar, - *“1. Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t'i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit...”.*

Gjatë hetimit administrativ konsatohet mbajtja e dosjeve me të dhëna personale sensitive të përfitueseve, më tepër se sa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej. Këto dosje, përmbajnë të dhëna sensitive me karakter vetjak dhe cenojnë jetën private dhe intime të përfitueseve.

Neni 3 "Përkufizime", pika 4 i Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, përcakton se:

"Të dhëna sensitive" është çdo informacion për personin fizik, që ka të bëjë me origjinën e tij, racore ose etnike, mendimet politike, anëtarësimin në sindikata, besimin, fetar apo filozofik, dënimin penal, si dhe të dhëna për shëndetin dhe jetën seksuale".

Zyra e Komisionerit pas përfundimit të procedurës së kontrollit ka dalë me aktin rekomandues, Nr.20 datë 16.06.2017, në lidhje me shkeljet e konstatuara sipas pikave të procesverbalit të mësipërm.

Në zbatim të nenit 5, germa "d" të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, i cili shprehet:

"1.Mbrojtja e të dhënave personale bazohet:

d) në mbajtjen në atë formë, që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër se sa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej", kontrolluesi Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza Tiranë, të parashikojë në rregulloren për "Mbrojtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale", afatet ligjore të ruajtjes së të dhënave personale (dosjet) e përfitueseve".

Në konsultimet paraprake që Zyra e Komisionerit ka zhvilluar me palët e interesuara, është konkluduar se afati i mbajtjes së dosjeve të "përfitueseve" nuk duhet të jetë më shumë se 10 vjet nga dalja e "përfitueseve" prej qendrës, duke marrë parasysh dhe monitorimin afatgjatë të tyre pas daljes nga qendra e trajtimit.

Zyra e Komisionerit vlerëson rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale, sidomos kur është fjala për të dhënat sensitive të individëve, përpunimi i paligjshëm i të cilave sjell pasoja të pariparueshme të jetës dhe privatësisë së tyre.

Neni 30, paragrafi 1, gërma "b" e ligjit të sipërcituar përcakton se:

"Komisioneri ka këto të drejta:

b) urdhëron bllokimin, fshirjen, shkatërrimin ose pezullon përpunimin e paligjshëm të të dhënave personale".

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 7, 29, 30 pika 1, germa "b" dhe 32 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Kontrolluesi Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza Tiranë, të realizojë në mënyrë të menjëhershme, pezullimin e përpunimit të të dhënave personale sensitive (dosjet) e subjekteve të të dhënave, kategoria "përfituese", që kanë mbi 10 vjet nga përfundimi i qëllimit për të cilin janë mbledhur.

2. Kontrolluesi *Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza* Tiranë, të parashikojë në rregulloren për "Mbrotjtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale", afatin 10 vjeçar të mbajtjes së dosjeve të "përfitueseve", pas daljes së tyre nga qendra përkatëse.
3. Kontrolluesi *Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza* Tiranë, të realizojë seleksionimin e dosjeve që disponon, deri në klasifikimin dhe verifikimin e saktë të tyre si:
 - a. Të dhëna personale sensitive (dosje) të ruajtura në përputhje me afatet ligjore.
 - b. Të dhëna personale sensitive (dosje) të ruajtura në shkelje të afateve ligjore.
4. Kontrolluesi *Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza* Tiranë, pasi të ketë vepruar sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij urdhëri, brenda një periudhe 60 (gjashtëdhjetë) ditore të realizojë shkatërrimin e të gjitha të dhënave personale sensitive (dosje) të arkivuara në kundërshtim me afatet ligjore.
5. Kontrolluesi *Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza* Tiranë, mbart detyrimin për të njoftuar Zyrën e Komisionerit, lidhur me zbatimin e detyrave të lëna në këtë urdhër, brenda 60 ditëve.
6. Në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrotjtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vendos sanksion administrativ me gjobë dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky urdhër u shpall sot më. 14/9 /2017

KOMISIONERI
Besnik Dervishi



14/9/2017